



ALBANIAN UNIVERSITY

Nr. 40 Prot.



BASHKIA TIRANË

Nr. 12164 / Prot.
/1

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

MIDIS

“ALBANIAN UNIVERSITY”

DHE

“BASHKIA TIRANË”

E lidhur sot më 08 02 2017 midis palëve:

Bashkia e Tiranës, me adresë: “Sheshi Skënderbej”, nr. 2, kodi postar 1001, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga **Z. Erion Veliaj**, Kryetar, në vijim e cilësuar si “**Bashkia**”

dhe

Albanian University, me adresë: “Blv. Zogu I”, përfaqësuar nga Rektori, **Prof. Dr. Vera Ostreni**, në vijim e cilësuar si “**Universiteti**”

Meqënëse:

Në bazë të neneve 23-27, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, Bashkia e Tiranës në kuadër të funksioneve dhe kompetencave të saj, është përgjegjëse për organizimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, në fushën e mbrojtjes së mjedisit, shërbimeve sociale, kulturës, sportit, etj.

Në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj si më lart, Bashkia e Tiranës është angazhuar në nisma të ndryshme, duke realizuar aksione dhe fushata sensibilizuese për këtë qëllim.

1

Bashkia e Tiranës dhe "Albanian University" në Tiranë hyjnë në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi me fokus kryesor angazhimin e studentëve të "Albanian University" në fushata vullnetarë ndërgjegjësuere të ndërmarra nga Bashkia Tiranë.

Palët lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti

Objekti i marrëveshjes është vënia në dispozicion të Bashkisë nga Universiteti i një numri të caktuar studentësh, të cilët do të shërbejnë si vullnetarë në nismat e ndryshme në fushën e mbrojtjes së mjedisit, shërbimeve sociale, kulturës dhe sportit që do të ndërmerren.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i marrëveshjes është që me anë të angazhimit vullnetar dhe nismave të ndryshme, të kemi një qytet më të mirë, duke ndërgjegjësuar sa më shumë njerëz dhe duke i ftuar ata të fundit të bëhen pjesë e këtyre nismave.

Neni 3

Baza Ligjore

Kjo marrëveshje bazohet në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen vendore".


Neni 4

Angazhimet e Palëve

1. Të dy palët bien dakord të bashkëpunojnë në frymën e një mirëkuptimi reciprok si dhe me vullnetin pozitiv për të siguruar kushtet e nevojshme për realizimin e angazhimit vullnetar të studentëve në nismat dhe iniciativat e ndërmarra nga Bashkia Tiranë ose në bashkëpunim.
2. Palët bien dakord të shkëmbejnë eksperiencën dhe të shfrytëzojnë kapacitetet e përbashkëta njerëzore dhe teknike nëpërmjet projekteve të përbashkëta.
3. Për periudhën e angazhimit, studentët janë të detyruar t'i nënshtrohen rregullave dhe kërkesave të Bashkisë.



2

Universiteti merr përsipër:

- A. Të prezantojë paraprakisht numrin e studentëve të cilët do të angazhohen në aktivitete te ndryshme.
- B. Të respektojë rregullat e parashikuara në rregulloret e brendshme, si dhe në legjislacionin në fuqi me anë të të cilit bëhet rregullimi i funksionit të institucionit, përfshi respektimin e orareve të përcaktuara.
- C. Të hartojë një program të përbashkët me institucionin për futjen në shërbim të tij pa pagesë të studentëve gjatë angazhimit të tyre.
- D. Të mbështesë institucionin pritës, nëpërmjet vënies në dispozicion të stafit trajnues në projekte të përbashkëta me qëllim rritjen dhe përmirësimin e cilësisë së aktivitetit.

Bashkia merr përsipër:

- A. Pranimin e angazhimit të studentëve sipas programit të parashikuar.
- B. Ofrimin e kushteve të nevojshme për kryerjen e detyrës dhe mbikqyrjen e punës me qëllim përfitimin e kualifikimit sa më cilësor.
- C. Dhënien e një certifikatë për çdo student në përfundim të angazhimit.

Neni 5

Dispozitat e fundit

Palët përgjigjen reciprokisht për respektimin e kësaj marrëveshje.

- Kjo marrëveshje lidhet me afat të pacaktuar;
- Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga palët;
- Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje origjinale për secilën palë.

“Albanian University”

Rektori

Prof.Dr. Vera Ostreni



Bashkia Tiranë

Kryetari

Z. Erion Veliaj

